

## Reformat e qeverisë lokale dhe decentralizimi

Misioni i OSBE-së në Kosovë që nga viti 2000 ka qenë e përfshirë në çështjet e qeverisjes lokale. Ka ndihmuar në strukturimin e administratave komunale të Kosovës duke trajnuar afro 5,000 nëpunës civil. Në bashkëpunim të ngushtë me zyrtarët vendor dhe të UNMIK-ut gjithashtu ka ndihmuar në zhvillimin e strukturave komunale. Pas zgjedhjeve komunale të vitit 2002 misioni u koncentrua në ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve të Kuvendit Komunal. Janë mbajtur gjashtë module të trajnimit të cilat i kanë ndjekur rreth 2,500 pjesëmarrës. Gjatë gjithë procesit është krijuar një bashkëpunim efektiv mes Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Hartmut Purner, OSBE

### Të angazhuarit

OSBE-ja ka arritur sukses të madh duke ndihmuar zhvillimin e politikave komunale dhe ky është një besim që Misioni në Kosovë gjithashtu mund të kontribuojë në reformimin e vetë-qeverisjes lokale.

Megjithatë, nuk ishte lehtë të mirret vendimi se a duhet të përfshihet misioni në këtë çështje. Mandati i OSBE-së është që të ndihmojë ngritjen e institucioneve dhe demokracisë, dhe që të shihet dobia që reforma e qeverisë lokale do të sillte në këto dy fusha. Duke parashikuar këto kërkesa kryesore dhe duke sjellur një përvojë me perspektivë OSBE-ja ka ardhur deri në këtë përfundim dhe ka vendosur të angazhohet dhe të ndihmojë në reformimin e institucioneve komunale.

### NË KËTË NUMËR

Njerëzit e hutuar rreth decentralizimit fq. 3

Intervistë me Lutfi Haziri fq. 4

Këshillat e fshatrave në Viti fq. 8

JO Ligjore ndaj diskriminimit fq. 11



Më 22 shkurt të vitit 2005, Qeveria e Kosovës ka miratuar Planin e Punës për Dokumentin Kornizë për Implementimin e Reformës për Qeverisje Lokale.

### Çfarë duhet të bëjnë qeveritë komunale?

Duke analizuar situatën e përgjithshme, misioni ka vërejtur mungesën e qartësisë lidhur me distribuimin e përgjegjësisë mes autoriteteve komunale dhe ministrive të themeluara kohët e fundit, për shembull në sektorët e shëndetësisë dhe të arsimit.

Kompetencat kryesore tradicionale të komunave – dispozita e shërbimeve publike dhe menaxhimi i pronësisë – janë hequr nga duartë e tyre. Kjo e ka kufizuar shumë mundësinë e përgjigjes së kërkesave të qytetarëve në mënyrë të efektshme.

Në anën tjetër, shumë komuna kanë filluar interpretimin dhe implementimin e disave nga legjislacionet kryesore, siç janë rregulloret për shërbime civile, në një mënyrë që të përshatën më së miri sidomos menaxhimin komunal, por jo çdoherë në vijë me konceptin dhe frymën e ligjit përkatës.

Ishte logjike se duhet të ketë vizion të qartë, përvijimi dhe definimi i përgjegjësisë që bien nën komuna dhe atyre të ministrive. Prandaj, shumë nga kompetencat që i janë dhënë nivelit qëndror duhet t'iu kthehen komunave, t'iu ndihmohet që t'iu shërbejnë opinionit publik në mënyrë efektive. Në të njëjtën



Sven Lindholm  
Zëdhënës, Misioni i OSBE-së në Kosovë

pushtetit lokal ka për qëllim t'iu mundësoj komuniteteve të administrojnë çështjet më mirë se qeveritë e tanishme në komunitetet e tyre, decentralizimi është transferim i pushteteve qendrore në nivele më të ulëta të Qeverisë.

Ajo çka do të ndodhë në Kosovë është reformimi i pushtetit lokal, që do të mundësoj krijimin e një pushteti të vërtetë lokal që do të kujdeset për çështjet krejtësisht lokale. Të citojmë Dokumentin Kornizë: "Kjo reformë ka për qëllim të kontribuoj në sigurimin e një qeverisje dhe kushteve të qëndrueshme të jetesës... ajo do të jetë në dobi të të gjithë komuniteteve, t'i adresojë nevojat për siguri dhe mbrojtje, dhe të kontribuoj në integrimin e të gjitha komuniteteve në strukturat demokratike në Kosovë."

Ky numër i DETAJEVE nuk do flet për atë se çka do të përfshijë reforma e pushtetit lokal gjatë vitit të ardhshëm, pasi që ka ende shumë gjëra për t'iu definuar. Kjo nuk është një nga veprimet por një proces i ndërlikuar, dinamik dhe afatgjatë. Ai kërkon një angazhim të vërtetë dhe të plotë të autoriteteve publike, dhe një angazhim të plotë të akterëve në të gjitha nivelet.

Qeveria e kryeministrit të ri, para vetes ka një dokument pune i cili ishte miratuar në parim disa javë më parë, para ndryshimeve të jashtëzakonshme politike. Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal është tani në proces të themelimit të grupeve

punuese, të cilat kanë për qëllim të ndihmojnë udhëzimin e procesit në krijimin dhe zhvillimin e njërive komunale pilote.

Një numër i forcave politike kanë kërkuar debat në Kuvendin e Kosovës para se procesi të shkoj tutje. Qeveria duhet të përgjigjet në pyetjet dhe të lehtësoj frikën se procesi do të jetë gjithë-përfshirës dhe do të zhvillohet në mënyrë të drejtë dhe jo-politike. M'iu këtë javë u arrit një marrëveshje në mes liderëve politik për të patur një konsensus mbi prioritetet duke përfshirë reformimin e pushtetit lokal.

Kjo është një pjesë e opinionit publik dhe politik për të shprehur se është e paqartë ajo që do të ndodhë. Ata natyrisht se kanë të drejtë të jenë të informuar. Dhe ka të bëjë me Qeverinë, më hollësisht me Kryeministrin dhe me Ministrin e Administratës së Qeverisë Lokale, që të nxjerrin planin më të ri, si dhe të marrin porosinë përmes këtij qëllimi "Një qeveri lokale më efektive nëpërmes kalimit të përgjegjësisë jo të rezervuara tek autoritetet lokale."

Kjo është një mundësi e Qeverisë të tregojë transparencë në procesin e zhvillimit të pilot rajoneve dhe të demonstrojnë përgjegjësi ndaj atyre qytetarëve të cilët jetojnë në komunat e caktuara. Reforma e pushtetit lokal është një kontribut i rëndësishëm për të themeluar dhe konsoliduar institucione demokratike funksionale në Kosovë, si një nga Standardet për Kosovën.

Reformimi i pushtetit lokal. Për çka është fjala? Ky numër i DETAJEVE duket se mëton të tregojë se idea e përgjithshme e konceptit të këtij procesi, i cili do të ndodhë, është minimale.

Kjo, sidoqoftë, nuk është aq befasuese pasi që plani i punës, kohën e fundit ka qenë i aprovuar vetëm prej Qeverisë. Por qytetarët janë të befasuar për shkak të ndikimit të mundshëm mbi ta dhe komunitetin e tyre.

Reformimi i pushtetit lokal ndonjëherë quhet decentralizim. Konceptet janë të bazuara ngjashëm, por në të vërtetë janë mjaft të ndryshme. Aty ku reformimi i



## DETAJE

Gazetë e publikuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë

OSCE HQ, 38000 Prishtinë / Prishtina, Kosovo  
Tel: +381 38 500 162, Fax: +381 38 500 188  
E-mail: [press.omik@osce.org](mailto:press.omik@osce.org)  
Web site: [www.osce.org/kosovo](http://www.osce.org/kosovo)

Botuesi:  
Sven Lindholm

Kryeredaktor:  
Nikola Gaon

Redaktorë:  
Hasan Sopa, Armend Tahirsylaj (Detaje)  
Slaviša Mladenović (Detalji)

Faqosja:  
Shpend Kada

Bashkëpunorët:  
Hartmut Purner, Zana Limani, Hasan Sopa, Rexhep Krasniqi, Radoslaw Rzehak, Mevlude Salihu, Ardiana Sejdiu, Vasilija Stanić

**osce**  
Mission in Kosovo

Shënim:

Pikëpamjet e paraqitura apo prezantimi i materialeve të botuara nuk shprehin politikën, opinionet apo qëndrimet e misionit të OSBE-së në Kosovë.

# Njerëzit e hutuar rreth decentralizimit

Qeveria e Kosovës ka miratuar një plan për decentralizim me 22 mars, bazuar në dokumentin kornizë për reformë lokale që është aprovuar korrikun e kaluar.

Sipas këtij plani, pesë njësi-pilot të reja komunale do të krijohen brenda kufinjëve të komunave ekzistuese, të cilat do të kenë kompetenca dhe autoritet të njëjtë me komunat aktuale.

Zana Limani, IWPR Prishtinë

Komuna e Prishtinës, si komuna më e madhe në Kosovë, do të preket nga ky projekt, pasi që Graçanica, një fshat me popullsi serbe, është një nga pesë pilot-vendet. Katër fshatrat e tjera janë: Parteshi në Gjilan, Mamusha në Prizren, Hani i Elezit në Kacanik dhe Juniku në Deçan.

Sidoqoftë, shumë njerëz duket se janë të painteresuar dhe keq-informuar mbi këtë plan dhe çfarë në të vërtetë nënkupton ai.

“E pranoj se nuk mendoj shumë për decentralizimin,” thotë Eugen Salihu, student 25 vjeç. “E di se ka të bëjë me delegimin e kompetencave nga qeveria qendrore në komuna si i tillë, por nuk jam i sigurtë për çka është ky plan në të vërtetë.”

Salihu nuk është i vetmi që din kaq pak për decentralizimin. Shumë nga njerëzit që i pyetëm çka mendojnë për decentralizimin vetëm buzëqeshën dhe u larguan duke thënë se nuk dijnë asgjë.

Megjithatë, projekti ka shkaktuar një debat politik masiv dhe është shëndrruar në një çështje kundërthënëse. Partia kryesore opozitare ka kritikuar planin duke thënë se është ilegal dhe i implementuar në baza etnike.

Jakup Krasniqi, shef i grupit parlamentar të PDK-së dhe ish-minister i shërbimeve publike, ka thënë në një konferencë për shtyp se dokumenti kornizë është në kundërshtim me Kornizën Kushtetuese dhe Rregulloren 2000/45.

Por, reagimi i opozitës ka ngjallur frikë tek njerëzit se në fakt decentralizimi është planifikuar në baza etnike.

Enis Halimi, i diplomuar në Shkenca Politike, tha se ekziston frikë tek njerëzit se një plan i tillë mund të legalizojë enklavat siç është Graçanica, një ndër enklavat serbe në komunën e Prishtinës.

Në tërësi, njerëzit duket se janë të hutuar për atë se çka është decentralizimi dhe në shumë raste e kuptojnë si diçka negative.

Arben Qirezi, Zëdhënës i Kryeministrit, thotë se plani i decentralizimit nuk i përkrahë enklavat në asnjë mënyrë, përkundrazi iu ndihmon atyre të integrohen në institucionet vendore duke e sjellë qeverinë më afër tyre. “Tani atyre nuk iu duhen strukturat paralele, sepse të gjitha shërbimet do t’iu ofrohen në Graçanicë dhe nuk do të kenë nevojë të udhëtojnë deri në Prishtinë.”



*Njerëzit marrin aq shumë informata të pasakta lidhur me decentralizimin dhe kjo e vështirëson formulimin për qëndrimet e tyre në këtë çështje*

Lutfi Haziri, Ministër i Qeverisjes Lokale, thotë se plani do të debatohet publikisht me qëllim që t’iu shpjegohet më mirë njerëzve.

“Debatet publike që do të mbahen në komunat e prekura nga ky plan janë shumë të rëndësishme,” tha Haziri gjatë një koktei rasti organizuar për gazetarët nga ministria e tij.

Qirezi poashtu ka theksuar nevojën për të informuar qytetarët më mirë, duke shtuar se qeveria po përgatitë një fushatë e cila do të përfshijë intervista dhe deklarata.

Por, përkundër këtyre përpjekjeve, duket se nuk do të jetë lehtë të ndryshohet qëndrimi negativ i njerëzve.

“Njerëzit kanë krijuar perceptim negativ për decentralizimin dhe qeveria nuk do ta ketë të lehtë të ndryshojë atë pa marrë parasysh sa përpjekje bëjmë,” thotë Halimi. “Do të nevojitet kohë dhe angazhim i vërtetë për të zgjidhur çështjet që i brengosin qytetarët, siç janë personat e zhdukur, varfëria dhe enklavat.”

Por jo të gjithë i dorëzohen hutisë dhe jo të

gjithë i bashkangjiten korit të kundërshtimit.

“Unë kam votuar në zgjedhje, dhe kam dhënë votën time për të zgjedhur këto institucione, kështu që besoj se ato bëjnë gjithçka që është në mundësinë e tyre për të zgjidhur problemet tona,” thotë Florini, 33 vjeçar. “Nëse ata mendojnë se decentralizimi është ajo çfarë na duhet, atëherë unë i përkrahë.”

Debati mbi decentralizimin është planifikuar të mbahet në Kuvend. Xhavit Haliti, deputet i PDK-së në parlament, thotë se PDK-ja do të dal me një qëndrim përfundimtar në lidhje me këtë plan pasi ta ketë analizuar me kujdes draft dokumentin që e kanë marrë.

Sido që të jetë, sfida për ta bindur opozitën nuk do të jetë brenga e vetme e qeverisë. Ndryshimi i mosbesimit që qytetarët kanë në këtë plan është një sfidë tjetër me të cilën qeveria duhet të ballafaqohet.

“Ata duhet t’i lënë komunat ashtu siç janë,” thotë Sylaj, duke konfirmuar kështu mendimin e shumë njerëzve. “Nuk shoh çfarë të mire do të kemi nga kjo.”

# Duhet të bartim qeverisjen në nivelin lokal nëse duam që Kosova të bëhet pjesë e integritimeve evropiane

Rexhep Krasniqi, OSBE

*Çka do të ndodhë në Kosovë, decentralizim apo reformimi i qeverisjes lokale?*

Ministri Haziri: "Në Kosovë, do të duhet që ta ristrukturojmë qeverinë lokale sipas Dokumentit Kornizë për Reformimin e Qeverisë Lokale, të miratuar në korrik të vitit 2004. Debatet para miratimit të dokumentit dhe emërimit të grupit punues kanë qenë të fokusuar kryesisht në problemet e pushtetit lokal në Kosovë në kuptimin e organizimit të shërbimeve publike për qytetarët të cilët jetojnë largë nga institucionet lokale dhe kanë më pak qasje në institucionet komunale."

*Çfarë është dallimi në mes të reformimit të qeverisë lokale dhe decentralizimit?*

Ministri Haziri: "Në procesin e decentralizimit, qeveritë zakonisht bartin detyra ose pranojnë ndarjen e qeverisë në mes të dy niveleve administrative. Ne nuk jemi duke bërë këtë në Kosovë; ndarja e strukturave qeverisëse ekziston në Kosovë. Tani, ne jemi duke e definuar rolin e autoriteteve të nivelit lokal dhe përgjegjësitë që do t'i kenë. Qeveria qendrore ende do të ketë rol, mirëpo nuk do të mund të merr vendime. Strukturat lokale do të kenë këtë pushtet. Ky është dallimi më i madh."

*A është duke u përgatitur ligji për decentralizim, dhe nëse po, kur do të jetë gati?*

Ministri Haziri: "Dokumenti Kornizë dhe Vendimi i Qeverisë i korrikut 2004 janë baza ligjore për fillimin e fazës testuese për reformimin e pushtetit lokal."

*Qytetarët kanë paraqitur brengat e tyre në lidhje me këtë proces në debate. A do të mirren ato parasysh?*

Ministri Haziri: "Ky është vetëm fillimi. Qeveria do të organizojë debate në Parlament. Të gjitha grupet etnike dhe partitë politike që janë të përfaqësuara në Parlament do të kenë rastin të ofrojnë komentet e tyre. Hapi tjetër do të jenë diskutimet me OJQ. Unë jam për marrjen e propozimeve të qytetarëve parasysh."

*Qëndrimet e palës shqiptare dhe asaj serbe sa i përketë këtij procesi janë të ndryshme. Në tetor të viti 2004, serbët nuk donin të merrnin pjesë në zgjedhje nëse decentralizimi nuk do të ndodhte. A është kjo e vërtetë?*

Ministri Haziri: "Ky proces ka filluar më herët në Kosovë. Natyrisht, nuk mund të injorohen kërkesat e grupeve etnike, mirëpo asnjë plan jashtë Kosovës nuk ekziston në tavolinën tonë."



Lutfi Haziri, Ministër i Administratës për Qeverisje Lokale

*Disa shqiptarë kanë thënë se nëse Kosova bëhet e pavarur, decentralizimi do të sjellë ndarjen e veriut, pjesë e cila do të mbetet pjesë e Serbisë. A është kjo e vërtetë?*

Ministri Haziri: "Tani gjindemi në fazën testuese. Kufinjët e komunave janë të pacenueshëm dhe komunat aktuale ushtrojnë pushtetin e tyre. Vetëm Kuvendi i Kosovës mund të merr vendim për të ndërruar kufinjët dhe për të përcaktuar numrin e komunave. PSSP-ja është ai që e dikton këtë, mirëpo Kuvendi është organi më i lartë. Tani për tani, jemi duke u marrë me pilot projekte brenda komunave ekzistuese."

*A është bazuar korniza për reformimin e qeverisë lokale në ndonjë plan që është implementuar në ndonjë vend?*

Ministri Haziri: "Jo. Asnjë plan nuk i përshkruhet nevojave të Kosovës, sepse numri dhe pozita gjeografike e komunave ndryshon prej vendit në vend. Sa i përket territorit dhe popullatës, Kosova ka komunat më të mëdha në Evropën Jug-lindore. Dokumenti i vetëm të cilin e ka marrë parasysh Grupi Punues për Dokumentin Kornizë ka qenë sjellja e institucioneve më afër qytetarëve – që është një e drejtë që buron nga Karta Evropiane për Vetë-Qeverisje Lokale."

*Cilat janë kriteret kryesore për përzgjedhjen e një vendbanimi për pilot projekt?*

Ministri Haziri: "Kriteret për përzgjedhjen e një vendbanimi për pilot projekt janë shkalla e zhvillimit, struktura etnike, pozita gjeografike, si dhe rezultatet të cilat i presim nga niveli komunal. Ta marrim Prishtinën si shembull. Prishtina, kryeqyteti i Kosovës, ka statusin e njëjtë administrativ me komunën e Novobërdës. Prishtina do të ketë status special dhe organizim të shërbimeve dhe roli i udhëheqësve do të jetë shumë më i mirë. Në anën tjetër, njësia komunale e Graçanicës do të ketë autoritet regullativ dhe ekzekutiv dhe do të ofroj shërbime më të mira për banorët e saj sipas rregullave të komunave."

*Kush do t'i mbulojë shpenzimet e këtij procesi?*

Ministri Haziri: "Do të jetë Qeveria e Kosovës dhe buxheti i saj i konsoliduar. Reformimi është për neve. Donatorët, që janë duke punuar në Kosovë dhe duke e përkrahur Qeverinë e Kosovës, kanë premtuar se do të na ndihmojnë."

*Partia Demokratike e Kosovës, partia më e madhe opozitare në Kosovë, është kundër këtij procesi. A ka marrë pjesë ajo në përpilimin e planit për decentralizim gjatë mandatit të kaluar qeveritar?*

Ministri Haziri: "Ajo e ka udhëhequr procesin. Jakup Krasniqi, ish-Ministri i Shër-

bimeve Publike, ishte bashkë-kryesues i grupit punues. Marrëdhëniet kanë ndryshuar dhe PDK-ja e kundërshtoi dokumentin tani. Motivet janë kryesisht politike.

*Pas mbledhjes së Grupit të Kontaktit, Oliver Ivanoviq u paraqit me një qëndrim tjetër ndaj këtij procesi. A do të ndikojë reformimi i qeverisë lokale që serbët e Kosovës të integrohen në jetën e shoqërisë Kosovare?"*

Ministri Haziri: "Ai mund t'i inkurajoj ata. Ne do të krijojmë infrastrukturën ligjore për përfshirjen e serbëve, por ne nuk mund të presim edhe një kohë të gjatë. Ky proces është për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe kushdo që dëshiron që të ketë rol dhe shërbime do t'i ketë ato; procesi do të vazhdojë tutje. Sidoqoftë, që nga viti i kaluar, përfaqësuesit serbë kanë marrë pjesë vetëm në një mbledhje të Grupit Punues, kurse grupet tjera etnike kanë marrë pjesë rregullisht."

*A do të ballafaqohet ky proces me pengesa dhe nëse po, atëherë cilat janë kryesoret?"*

Ministri Haziri: "Meqenëse kemi të bëjmë me fazën testuese, kjo është një detyrë e vështirë e komunave dhe njësive komunale. Pengesa më e madhe për Qeverinë është aspekti buxhetor. Në kuptimin legjislativ, ne do të punojmë që të krijojmë infrastrukturën ligjore që do të sigurojë funksionimin normal të komunave dhe njësive komunale. Përgjegjësia e tyre kryesore do të jetë që ta kryejnë detyrën me efikasitet dhe ndershmëri. Nëse këto obligime nuk përmbushen, atëherë procesi do të rrezikohet. Për mua kjo është sfida kryesore. Qeveria do që të ketë një storie të suksesshme në terren."

*A e keni marrë parasysh planin e Këshillit të Evropës për decentralizimi?"*

Ministri Haziri: "E kemi trajtuar si dokument, mirëpo ai ka dështuar si i tillë. Jo vetëm ai, por edhe planet tjera. Ne jemi të angazhuar që të gjejmë një formë që i përshtatet interesave të qytetarëve të Kosovës. Sa kam parë unë, vëmendje i është kushtuar vetëm Konventës Evropiane për Vetë-Qeverisje Lokale."

*Në cilat shtete është duke u zhvilluar reformimi i qeverisë lokale?"*

Ministri Haziri: Ky është një obligim për të gjitha shtetet e BE-së. Nuk mund të pretendohet që të bëhesh pjesë e mekanizmave evropian pa një proces të tillë, ose pa e filluar atë. Ka shtete brenda BE-së të cilat janë në fazën e implementimit, siç janë Franca dhe Italia. Ka vende ku qeveritë lokale janë të zhvilluara shumë, siç është rasti me shtetet Nordike dhe Evropën Perëndimore. Realisht, shtetet e Ballkanit janë të fundit në Evropë sa i përket këtij procesi dhe proceseve tjera integruese. Proces i reformimit të qeverisë lokale është proces i patejkalueshëm nëse Kosova dëshiron të bëhet pjesë integruese e Evropës."

# Decentralizimi: Një çështje praktike apo politike?

Një nga çështjet më të diskutuara kohëve të fundit në Kosovë është decentralizimi. Si një koncept i përgjithshëm përmban në vete kalimin e pushtetit nga niveli qendror në atë komunal (vendor). Me pushtetin vijë edhe përgjegjësitë, prandaj gjithashtu kërkohet edhe transferimi i përgjegjësisë për çështje lokale në institucionet vendore, pra në këshilltarët dhe qeveritarët komunalë.

Nikola Gaon, OSBE



Dhe kjo nuk përfundon këtu. Nën këtë koncept komunitat mund të marrin përgjegjësi të plota për vetfinancimin e tyre duke përfshirë këtu edhe grumbullimin e taksave. Një pjesë e të hollave të mbledhura nga taksat mbetet në komuna dhe një pjesë shkon për financim të funksioneve të udhëhequra nga pushteti qendror, siç janë policia, arsimiti i lartë, institucionet e specializuara shëndetësore, ministritë, e kështu me radhë.

E tëra kjo është bërë në pajtim me Kartën Evropiane për vetëqeverisje lokale e cila e ofron regjionin më afër vendeve evropiane. Procese të ngjashme po kryhen edhe në Bosnje dhe Hercegovinë, Serbi dhe Mal të Zi, si dhe në Republikën e ish-Jugosllavisë-Maqedoni.

Në parim, kjo ide ka më shumë dobi sesa të meta. Sidoqoftë, procesi në Kosovë nuk është aq transparent dhe i shpejt siç është pritur. Çështja e një riorganizimi të mundshëm territorial duket të jetë arsyeja kryesore.

Nëse merren parasysh dispozitat e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, komuna më të vogla, por financiarisht të qëndrueshme, janë më të rekomandueshme. Ato i japin më shumë pushtet qytetarëve që jetojnë në to, dhe plotësojnë nevojat financiare të komunave.

Për momentin, një rrjedhë e tillë duket se nuk shkon në atë drejtim. Duket se decen-

tralizimi ka të bëjë shumë pak me dhënien e pushtetit qytetarëve dhe krijimin e komunave të afta për t'u vetfinancuar për nevojat e veta – arsimin deri në nivelin e mesëm, zhvillimin urban dhe ekonomik, infrastrukturën, si dhe nevojat themelore të shëndetësisë, që janë vetëm disa prej resorëve.

Për disa arsye decentralizimi është duke u bërë pretekst i getoizimit të komuniteteve, shfuqizimit të popullsisë lokale dhe ndarjes etnike. Procesi po bëhet viktimë e interesit të shumë grupeve – përfshirë serbët e Kosovës të cilët marrin ndihmë nga Beogradi dhe kanë një synim të mos jenë pjesë e shoqërisë kosovare dhe e beneficioneve të shqiptarëve të Kosovës të cilët dëshirojnë të mbajnë pushtetin në nivelin qendror.

Me këto grupe të cilat i zhvillojnë fushatat e tyre pro/kundër-decentralizimit, qytetarët e zakonshëm, pavarësisht etnicitetit të tyre, kanë shumë pak mundësi të fillojnë të ndihen të fuqishëm dhe në gjendje që t'i ndryshojnë gjërat për të mirë, të punojnë me pushtetin lokal, ose edhe të jenë aktiv dhe pjesëmarrës në jetën politike dhe në proceset vendim-marrëse. Kjo është befafuesë për faktin se njerëzit kanë kapacitet të mbikqyrin punën: a) e pushtetit lokal nëpërmes monitorimit dhe pjesëmarrjes së drejtpërdrejt; dhe b) punën e pushtetit qendror përmes përfaqësuesve në Kuvendin e Kosovës. Nëse ky pushtet shfrytëzohet plotësisht, qeveria do të duhet të jepte rezultate.

Nëse procesi i decentralizimit dhe fuqizimit të qytetarëve vonohet, strukturat politike të cilat përfitojnë nga 'status quo-ja' do t'i mbanin pozitat e tyre të privilegjuara. Ata ose do të vazhdonin të fitonin ndihmë ose të ruanin tërë pushtetin dhe kontrollin mbi fondet publike. Në këtë domethënie titulli i këtij artikulli nuk ka të bëjë me kuptimin politik ose praktik të decentralizimit. Kjo ka të bëjë me mbajtjen e privilegjeve të disave dhe moslënien e popullit të Kosovës të qeverisë në mënyrën më të mirën të mundshme.

Ky përfundim mund të jetë krejt i gabuar, por kjo është diçka që populli i Kosovës do ta kuptoj vetvetiu duke i vështruar ngjarjet që ndodhin në mes të tanishmës dhe kohës kur decentralizimi do të jetë i depolitizuar, kur pilot projektet të fillojnë dhe ata të fillojnë t'i shohin dobitë e kësaj reforme.

kohë duhet të ketë një mekanizëm mbikëqyrës të efektshëm që të vihet në vend për të siguruar komunat që të udhëheqin punën e tyre konform me rregulloren.

Shkurtimisht, ndërsa komunat duhet të marrin më shumë autonomi politike, ato gjithashtu duhet të integrohen në një sistem monitorues dhe mbikëqyrës që do të kishte siguruar respektimin e shtetit ligjor.

Një reformë, e cila do të ishte përkujdesur për të gjitha këto, do të shërbente për përforcimin e institucioneve të Kosovës. Por çështje e hapur është a do të bëhen këto institucione më shumë demokratike?

### Reforma e Qeverisjes Lokale

Demokracia bazohet në komunikimin në mes njerëzve të cilët mendojnë se kanë intererese të përbashkëta dhe janë të lidhur së bashku nga fryma e komunitetit. Ky nocion është shumë i vërtetë, madje edhe më shumë kur kemi të bëjmë me vetë-qeverisjen lokale. Vetë-qeverisja lokale është më e afërta për qytetarët dhe ka mandat për të rregulluar çështjet e përditshme që burojnë nga zemra e komunitetit lokal dhe të çdo njeriu që jeton në rajon të caktuar.

Lidhur më këtë çështje janë zbuluar disa gjëra të çuditshme në sistemin komunal të Kosovës. Ndërsa Kuvendi Komunal është zgjedhur në mënyrë demokratike, fshatrat kërkonin që të ketë ndikim përmes një kanali direkt mes udhëheqësve të fshatrave dhe nëpunësve civil. Ankesat ishin të rëndomta për pjesët e caktuara gjeografike të komunave të cilat nuk ishin përfillur në favor të të tjerave. Banorët e qendrave urbane kundërshtojnë se interesat e tyre ishin vënë në rend të dytë nga fshatrat. Ose me fjalë tjera, fshatarët ndiheshin sikur kishin mbetur mbrapa banorëve të qyteteve. Sidoqoftë të gjithë u ankan për mungesën e mundësisë së sqajes së strukturave politike lokale, duke pohuar se qeverisja lokale ende është shumë larg. Të gjitha këto çojnë deri te përfundimi se përbërja e tanishme e komunave të cilat mesatarisht kanë një popullatë prej 80,000 dhe madhësi gjeografikisht të ngjashme, zakonisht të përbëra nga një qendër urbane dhe një grumbull i disa fshatrave, mund të jenë shumë të mëdha për të lejuar një vullnet të duhur në komunitet, debat demokratik, dhe ofrim të shërbimeve efektive. Kjo çon në një përfundim të qartë që një madhësi më e vogël dhe strukturë komunale mund të ndihmojë përforcimin e demokracisë në Kosovë.

### Marrja me strukturat paralele

Përderisa këto vlerësime mund të jenë të mjaftueshme në rrethana të ndryshme, në Kosovë marrëdhënjet etnike të ndjeshme dhe ekzistenca e strukturave duhet të merren parasysh.

Gjatë reformave mund të ndihmohet përmirësimi i marrëdhënieve etnike dhe në të njëjtën kohë të ndihmojë shpërbërjen e strukturave paraleleve, kjo mund të bëhet madje një

sukses edhe më i madh.

Gjatë vlerësimit të situatës, çështja e strukturave paralele ka treguar dy aspekte. Së pari, strukturat paralele i shërbejnë një agjende politike. Së dyti, strukturat paralele ofrojnë shërbime vendimtare të cilat nuk janë në shërbim adekuat për serbët e Kosovës nga strukturat ekzistuese të IPVQ-së, si është konfirmuar nga raportimi i Misionit të OSBE-së.

Përderisa çdo kontribut për agjendën e Beogradit duhet të shmanget, ka shpresë se reformat do të kishin bërë shërbimet e ofruara nga shërbimet paralele të jenë të panevojshme duke lejuar serbët e Kosovës dhe komunitetet tjera të adresohen në çështjet e tyre në sistemin e reformuar të vetë-qeverisjes lokale. Këto struktura të reformuara do të ishin plotësisht të inkuorporuara në IPVQ dhe strukturat paralele do të zhdukeshin.

### Opinionet për reformat e qeverisjes lokale dhe decentralizimi

Kur misioni vendosi të angazhohet në diskutime për reformat e vetë-qeverisjes lokale, kah fundi i vitit 2002, është kuptuar se nuk kanë ekzistuar parakushtet e domosdoshme për debat të bazuar në fakte për këtë çështje.

Reagimet për çdo përmendje për reforma ishin tërësisht emocionale. Përfaqësuesit shqiptarë të Kosovës do të frikoheshin për ndarjen e Kosovës; Serbët e Kosovës do të ankoheshin se ata nuk do të fitojnë asgjë nga ky proces. Si përgjigje misioni ka vendosur të mundohet dhe zbusë çështjen duke ofruar informim përkatës.

Në bashkëpunim me OJQ-në kosovare KIPRED misioni ka angazhuar tre ekspert për shqyrtim – kah fundi i vitit 2002 dhe fillimi i vitit 2003. Ekspertët për vet-qeverisje lokale nga Shqipëria, Austria, Maqedonia, Hungaria, Italia, Sllovenia dhe Zvicra kanë këmbyer përvojat me nëpunësit civil kosovar dhe politikanë, si dhe me përfaqësues të komunitetit ndërkombëtarë me bazë në Prishtinë.

Ndërkohë PSSP ka ftuar Misionin për decentralizim të Këshillit të Evropës për të nxjerrë rekomandime për strukturat e reja të qeverisjes lokale. OSBE-ja ka ngritur njohurinë dhe ekspertizën e vet të cilën e ka akumuluar që nga viti 1999 në rekomandimet e Këshillit të Evropës të lëshuara në vitin 2003. Misioni më tutje ka ndihmuar me distribuim më të gjerë të raportit të përkthyer në gjuhët e vendorëve.

### Moment i ri

Reforma e vetë-qeverisjes lokale ka arritur një moment të ri, në qershor të vitit 2004 kur IPVQ-ja dhe UNMIK-u kanë vendosur të bashkojnë përpjekjet e tyre për një zgjidhje më të mirë të mundshme dhe kanë formuar grupin punues duke i dhënë përgjegjësi për të përpiluar një "Dokument Kornizë për Reformimin e Vetë-Qeverisjes Lokale". OSBE-ja ishte anëtare e grupit.

Duke vepruar sipas dokumentit kornizë dhe rekomandimeve të tij, në vjeshtë të vitit 2004,

Misioni i i OSBE-së, Ministria e Shërbimeve Publike, dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës filluan implementimin e projektit të përbashkët duke u përqëndruar në përmirësimin e marrëdhënieve drejtuese mes strukturave komunale dhe qëndrore të IPVQ-së.

Gjatë muajit shkurt, procesi i implementimit të dokumentit kornizë ka arritur një kryqëzim rrugësh të rëndësishme. IPVQ-ja do të duhet të transformoj zotimet që ka bërë në punën konkrete.

Dokumenti kornizë ka ofruar bazë për ligjin e ri për vetë-qeverisje lokale dhe ligjin e ri për financat komunale. Dokumenti gjithashtu rekomandon të testuarit e zbatueshmërisë të reformës së propozuar në numrin e limituar të njësive pilote komunale.

Misioni i OSBE-së është i gatshëm të jap kontributin për këtë proces. Ekspertët e tij janë në disponueshmëri për të ndihmuar në hartimin e ligjeve dhe të këshillojnë për ngritjen e Ministrisë së re të Administratës së Vetë-Qeverisjes Lokale. Së bashku me UNMIK-un, Ministria e re do të drejtojë procesin e reformës. Për më tepër stafi i OSBE-së në terren është në dispozicion për të trajnuar zyrtarët e sapoemëruar, ende në formim e sipër, njësit pilot komonale, dhe të mbështesë themelimin e administratës së tyre.

### Reforma e Vetë-Qeverisjes apo decentralizimi?

Dhe së fundi, një pjesë e këtij procesi sqaron dallimin në mes të reformës së vetë-qeverisjes lokale dhe decentralizimit. Kjo nuk është një gjë e njëjtë.

Reforma e vetë-qeverisjes lokale do të mundësojë komunitetet vendore (dhe prapë, vendore nuk do të thotë etnike) për të administruar më mirë çështjet e përditshme që kërkohet në komunitete, siç janë: infrastruktura; zhvillimi ekonomik lokal, mirëmbajtja e qerdheve të fëmijëve dhe ndërtesave të shkollave, përgjdhja e mësimdhënësve; shërbimet komunale; mirëmbajtja e hapësirave publike dhe pronësisë, dhe ruajtja e traditave vendore dhe trashëgimisë. Praktikrat e tilla do të përfordronin funksionimin e institucioneve të Kosovës dhe do të ishte një hap më shumë në proceset e demokratizimit.

Termi "demokratizim", i kuptuar në kontekstin e ish-Jugosllavisë, paraqet bartje tek autoritetet legjislativë dhe ekzekutivë dhe themelimin e nivelit të ultë të qeverisë, mundësisht të kombinuar me krijimin e strukturës së re si njësitë territoriale, dhe jo themelimin e një qeverisje lokale të nivelit të vërtetë që do të përkujdesej për çështjet që do të merrej vetëm me komunitetet lokale, siç është ruajtja e kulturës, infrastrukturës lokale, apo shërbimeve komunale.

Për këtë arsye terminologjia e përdorur në këtë çështje duhet të standardizohet dhe duhet të përdoret termi "reforma e vetë-qeverisjes lokale". OSBE-ja do të vazhdojë të përqëndrohet në reformë.

# Qeveritë komunale dhe OJQ-të vendore mund të bashkëveprojnë

Pjesëmarrja e qytetarëve në punën e institucioneve komunale, transparanca e qeverisë dhe përgjegjësitë e tyre janë elemente esenciale të demokracisë së mirëfilltë. Prandaj është me rëndësi të madhe që qytetarët në demokraci të kenë qasje të plotë në informim por edhe t’iu ipet mundësia për të zgjedhur mbi këtë bazë.

Hasan Sopa, OSCE

Të dy sektorët e shoqërisë civile, pra institucionet vetëqeverisëse dhe organizatat jo-qeveritare (OJQ), duke mos e përjashtuar sektorin e tretë atë komercial, mund të bëjnë shumë në reformimin e qeverisjes lokale me qëllim të ofrimit qytetarëve shërbime më të mira dhe plotësimin të kërkesave të tyre. Një bashkëpunim i tillë është mëse i domosdoshëm për themelimin e institucioneve de-mokratike dhe funksionale. Në këtë drejtim hapa pozitiv janë bërë edhe në regionin e Pejës.

## Qasje më të lehtë në institucione lokale

Në komnatat e Deçanit dhe Malishevës, institucionet qeverisëse dhe OJQ-të vendore janë mjaft aktive në inkurajimin e qytetarëve që të angazhohen më tepër për interesat e tyre. Pikërisht këtu mbështetet edhe ideja e projektit të përbashkët në mes të OSBE-së dhe zyrtarës për informim në Malishevë, ‘Informata Qytetarve’, që shënon një progres drejtë themelimit të institucioneve demokratike dhe një përfshirje më të madhe të qytetarëve.

Hapja e zyrës për vizitorë në hyrje të kuvendit komunal u mundëson qytetarëve një qasje më të lehtë në institucionet komunale. Qytetarët kthejnë aty pa hezitim dhe informohen për çdo gjë që u intereson.

Kjo zyrë ofron shërbime dhe informata themelore për qytetarët. Gjithashtu, ofron edhe këshilla për çështje më komplekse që kanë të bëjnë me punën e administratës komunale, sikur se janë iniciimi i projekteve zhvillimore, plotësimi i kërkesave për riparime në infrastrukturën komunale, përfshirë rrugët, përkujdesjen për ujrat e zeza por edhe shumë shqetësime të tjera.

Qytetarët janë shumë të kënaqur me shërbimet e ofruara nga kjo zyrë por edhe me cilësinë e këtyre shërbimeve. Përveq shërbimeve efikase dhe cilësore kjo u kursen atyre edhe kohë gjatë vizitave që ata i bëjnë administratës komunale.

Përgjegjësjë e kësaj zyre Merita Bacaliu, thotë se puna e saj është t’i informojë qytetarët për aktivitetet e ndërmarrura dhe t’i inkurajojë ata të kyqen në institucionet e tyre. “Ne jemi në shërbim të qytetarëve. Nuk është vetëm detyrë, por edhe obligim i yni”, thotë ajo.

Në mungesë të ligjit i cili do ta rregullonte çështjen e informimit publik, Merita ka marrë iniciativën për një gjë të tillë dhe me ndihmën e OSBE-së ajo tani paraqet një shembull pozitiv.



*“Ne jemi në shërbim të qytetarëve. Nuk është vetëm detyrë, por edhe obligim i yni”, thotë Merita Bacaliu, zyrtare për informim publik pranë kuvendit komunal në Malishevë*

## Monitorimi i institucioneve komunale

Sektori i shoqërisë civile luan një rol të rëndësishëm në krijimin e një administrate komunale më efektive. Ka rolin ndërmjetsues në mes të administratës vendore dhe qytetarëve. Organizatat joqeveritare gjithashtu monitorojnë punën e zyrtarëve komunal dhe shërbimet që ata ofrojnë. Por më e rëndësishmja, ata mundohen të ndikojnë në proceset vendim-marrëse dhe bashkëpunojnë me qeverinë në planifikimin, zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve publike.

‘Shoqata e Intelktualëve të Pavarur’ të Deçanit me projektin e tyre ‘Ura Qytetare’, ka për qëllim inkurajimin e qytetarëve që të kyqen në institucionet komunale nga se sipas z. Adem Lushaj, Drejtor ekzekutiv dhe koordinator i projektit, kjo është e lidhur ngusht me përmirësimin e shërbimeve publike. “Një hap i vogël drejt shërbimeve më të mira qytetare” thotë ai.

Sipas tij projekti kryesisht ka të bëjë me vëzhgimin e punës së institucioneve komunale dhe shërbimet që ata u ofrojnë qytetarëve. “Vëzhgimi i shtëpisë së shëndetit ka zgjatë tre muaj dhe është fokusuar në sferën e menaxhimit, shërbimit, buxhetit, transparencës dhe respektimit të orarit të punës, ku kemi

gjetë shumë parregullsi”, thotë z. Lushaj dhe shton; “Ky ka qenë një sukses i madh ngase është arritë një vetëdijesim i mirë, bile edhe drejtori i shtëpisë së shëndetit e ka marrë këtë çështje me shumë seriozitet”.

Kur ne e pyetëm se si do të informoheshin qytetarët për të gjitha këto, z. Lushaj tha se kjo bëhet me anë të publikimeve të vogla si buletinit informativ, fletëpalosjeve por edhe përmes mediave lokale. “Debatet publike në radiot lokale janë forma më e mirë ku qytetarët njoftohen jo vetëm rreth punës së projektit dhe shërbimit që atyre u ofrohen, por edhe për të drejtat që ata i kanë dhe që duhet t’i realizojnë”, shpjegon z. Lushaj.

## Shkëmbim përvojash

Ditë më parë OSBE-ja ka organizuar një takim në mes të ‘Shoqatës së Intelktualëve të Pavarur’ të Deçanit dhe zyrtares për informim publik pranë kuvendit komunal të Malishevës. Në këtë takim ishin prezent edhe disa OJQ nga regionin.

“Qëllimi i vizitës sonë është që të njihemi me përvojën e zyrtares për informim në komunën e Malishevës. Kjo ka lidhshmëri të ngushtë me projektin tonë që ka të bëjë me transparencën e institucioneve komunale. Njëra prej pikave referuese është edhe zyra për informim publik. Kjo do të na ndihmojë t’i bartim disa përvoja nga komuna e Malishevës dhe t’i përfshijmë në raport për rekomandime në të ardhmen”, përfundon z. Lushaj.

Në fund, këto rekomandime do të prezantohen para kuvendit komunal të Deçanit për shqyrtim.

Sipas zyrtarit për demokratizim pranë zyrës rajonale të OSBE-së në Pejë Stuart Kefford, me projekte të këtilla shpresohet të bëhet ngritja e kuadrove profesionale e me këtë edhe përmirësimin e shërbimeve publike. “Unë edhe më herët e kam thënë se ne nuk jemi këtu t’i kryejmë punët e zyrtarëve vendorë, por për t’i ndihmuar ata të bëjnë punën e vet”, thotë z. Stuart.

Gjithsesi, projektet e tilla do të ndikojnë në krijimin e një vetëdije më të lartë qytetare. Përgjegjshmëria më e lartë e zyrtarëve komunal dhe pjesëmarrja aktive e qytetarëve në punën e institucioneve lokale, rezulton në shërbime më të mira qytetare dhe për një jetë më kualitative për të gjithë.

# Këshillat e fshatrave në Viti, një hap para decentralizimit

Kuvendi komunal i Vitisë ka nxjerr një vendim në mars të vitit 2003 për krijimin e këshillave të fshatrave, për të qenë më afër qytetarëve dhe për t'iu ofruar atyre shërbime më të mira.

Mevlyde Salihu, OSCE

Një udhëtim i ngadalshëm dimëror na shpie në Drobesh, një fshat i madhësisë së mesme me rreth 1,790 banorë, në hyrje të qytetës së Vitisë. Edhe pse fshati duket i fjetur në një ditë të ftohtë dimri, dhe rrugët e zbratura, një njeri shtatgjatë na pret para një shtëpie të vogël, dhe me ngrohtësi na fton brenda.

Avdulla Kadriu, rreth 50 vjeç, është kryetar i fshatit Drobesh, por ai këtë funksion e ka ushtruar për një kohë të gjatë. Edhe pse në këtë detyrë që nga fillimi i viteve të 90-ta, pozita e tij është zyrtarizuar në vitin 2003.

“Fshati ka mbajtur zgjedhje me 23 gusht të vitit 2003, dhe ka zgjedhur këshillin e fshatit, i cili përbëhet nga gjashtë anëtarë dhe unë si kryetar,” tha Avdullai. “Të gjitha lagjet e fshatit janë të përfaqësuara në këshill,” shtoi ai.

Në mënyrë që të jetë më afër qytetarëve dhe t'i adresojë nevojat e tyre më mirë, kuvendi komunal i Vitisë ka vendosur të krijojë këshillat në të gjithë fshatrat e komunës. Banorët e të gjitha fshatrave kanë votuar dhe drejtpërdrejt kanë zgjedhur anëtarët e këshillave dhe kryetarët. Detyra e këtyre këshillave është të caktojnë prioritetet dhe të punojnë në realizimin e tyre. Çështjet të cilat nuk mund të zgjidhen në fshat, i paraqiten autoriteteve komunale.

“Në mars të vitit 2003 ne kemi vendosur të formojmë këshilla të fshatit në çdo fshat të komunës. Këta këshilla kujdesen për nevojat e banorëve,” tha Musa Misini, kryetar i kuvendit komunal të Vitisë, duke shtuar, “ne kemi zgjedhur një model të cilin nuk mund ta quajmë decentralizim, por ofrim të shërbimeve për qytetarët. Kemi dashur t'i sjellim qytetarët më afër institucioneve komunale.”

Përvoja e gjatë e punës e bënë Avdullain jo vetëm të njohur dhe respektuar nga banorët e fshatit, por edhe shumë efikas. Përveç hartimit të prioriteteve dhe shpërndarjes së ndihmave sociale për familjet që kanë më së shumti nevojë, këshilli ka ndihmuar në ndërtimin e shkollës dhe dy trafostacioneve elektrike. Këshilli gjithashtu ka arritur të mbledh 1,000€ nga banorët për të ndihmuar komunën të shtrojë një rrugë të fshatit me zhavor.

“Ne kemi një shkollë të re dhe dy trafostacione elektrike poashtu të reja, kurse tani jam në bisedime me kryetarin e komunës në lidhje me rrjetin e kanalizimit sepse me të



Musa Misini, Kryetar i Kuvendit Komunal të Vitisë –  
 “Në mars të vitit 2003, ne kemi vendosur të formojmë këshillin e fshatit në secilin fshat. Këshillat e fshatrave përkujdesen për nevojat e banorëve.”

vërtetë është i domosdoshëm,” thotë Avdullai. “Autoritetet komunale janë shprehur të gatshme të ndihmojnë mirëpo ne duhet të marrim pjesë me 20% të investimeve. Kjo na shkakton vështësi pasi gjendja e fshatit është e mjerueshme, sidoqoftë besoj se brenda këtij viti do ta finalizojmë edhe këtë projekt.”

Qytetarët shprehen të kënaqur me punën e njerëzve që ata kanë zgjedhur për t'i përfaqësuar. “Po, ai bën punë të mirë,” thotë Idriz Brahimi, 22 vjeçar nga Drobeshi. “Ai

sillet mirë me njerëz, është korrekt në ndarjen e ndihmave humanitare dhe iu ndihmon atyre të cilët me të vërtetë kanë nevojë.”

Vitia është njëra ndër komunat e njohura për bashkëjetesë etnike. Këshillat shumëetnik janë edhe një dëshmi më shumë për këtë. Binça është një fshat me rreth 150 shtëpi, 40 prej tyre serbe, shtatë kroate dhe të tjerat shqiptare.

“Këshilli jonë numëron shtatë anëtarë, katër shqiptarë, dy serbë dhe një kroat,” thotë





*Komuna e Vitisë përpiqet të përfshijë sa më shumë njerëz që është e mundur në proceset e vendim-marrjes. Njerëzit e dinë më mirë për çfarë lloj ndihme kanë nevojë nga autoritetet kur ka të bëjë me infrastrukturën dhe zhvillimin ekonomik.*

Drane Simoni, kryetare e fshtatit Binçë. “Në fakt,” thotë ajo, “ne kemi rezervuar dy vende për serbët sepse ata akoma nuk e kanë pranuar pozitën e anëtarëve të këshillit zyrtarisht, por de facto, ata vijnë në takime dhe bashkëpunojnë.”

Këshilli në Binçë është themeluar për herë të parë pas iniciativës së komunës në vitin 2003. Edhe pse nuk ka funksionuar plotësisht deri në maj të vitit 2004 dhe nuk e ka përvojën që e ka Drobeshi, ky këshill është shumë aktiv dhe punon në mënyrë shumë efektive.

“Këshilli mban takime të rregullta mujore ku i diskutojmë problemet. Takimet janë të hapura për qytetarë, të cilët shpesh i shprehin problemet dhe brengat e tyre,” thotë Dranja.

“Problemi kryesor në fshatin tonë,” thotë ajo, “është sistemi i ujësjellësit. Ujësjellësi është ndërtuar por shërben vetëm si dekorim. Fshati nuk ka ujë, por jemi në kontakt me kryetarin e Vitisë dhe një OJQ zviceriane për ta përmirësuar situatën.”

Kroatët janë anëtarë të rregullt të këshillit dhe punojnë së bashku me shqiptarët.

Serbët, edhe pse zyrtarisht nuk janë pjesë e këshillit, janë aty dhe punojnë poaq sa të tjerët kur janë në pyetje interesat e përbashkëta të banorëve.

Edhe pse shumica e banorëve të Binçës nuk kanë të ardhura, Dranja thotë se kanë arritur të mbledhin të holla për të shtruar rrugën që kalon nëpër fshatin e saj. “Edhe pse të gjithë janë të papunë, përveç atyre që jetojnë jashtë vendit, kemi arritur të mbledhim 17,000€ për të shtruar rrugën. Edhe serbët kanë kontribuar në këtë projekt, simbolikisht, por kanë kontribuar, dhe ky është një sukses i madh i këshillit.”

Zoran Marinkoviç, nga Binça, përfaqësues i serbëve, thotë se ai nuk është anëtar i këshillit por vetëm i përfaqëson serbët. Arsyeja për këtë, thotë ai, është se këshilli është krijuar pas trazirave të 17 marsit, dhe serbët vendor thjeshtë e kanë humbur besimin në institucionet.

“Sidoqoftë,” thotë Marinkoviç, “dua të theksoj se kemi bashkëpunim shumë të mirë me përfaqësuesen shqiptare. Si përfaqësues i serbëve, nuk jam anëtar i këshillit por kjo nuk është e rëndësishme, sepse ne funksionojmë. Unë dhe Dranja aktualisht jemi

duke punuar në projektin për sistemin e ujësjellësit i cili është në të mirë të të gjithë banorëve.”

Binça nuk është fshati i vetëm ku këshillat e përzier funksionojnë në mënyrë efektive. “Kemi raste të ngjashme në fshatrat Bogorc, Zhiti dhe Gërmov, ku banorët kanë formuar këshilla të përbashkët, kanë vlerësuar nevojat dhe ia kanë prezentuar institucioneve komunale,” tha kryetari i komunës së Vitisë.

Përfaqësuesit e fshatrave janë një lidhje në mes të autoriteteve dhe qytetarëve, që është treguar shumë e suksesshme. Autoritetet i marrin informatat dhe listën e prioritetëve nga njerëzit të cilët realisht e njohin situatën. Kjo ndihmon zgjidhjen më të shpejtë të problemeve dhe i bën njerëzit të ndjehen më pak të marginalizuar dhe më afër autoriteteve.

“Ne mendojmë se formimi i këshillave të fshatrave duhet të jetë bazë për decentralizim. Qytetarët kanë nevojë për shërbime, dhe ne e shohim decentralizimin në funksion të ofrimit më të mirë të shërbimeve për qytetarët,” përfundon Musa Misini, kryetar i komunës së Vitisë.

# Pikëpamjet e partive politike për decentralizimin

Reformimi i pushtetit vendor është një proces i rëndësishëm në forcimin e institucioneve të Kosovës dhe plotësimin e një morie aspektesh të "Standardeve për Kosovën". Mirëpo, ky proces në asnjë mënyrë nuk guxon të shihet mbi baza politike e aq më tepër të prejjudikoj ndarje territoriale në baza etnike. Pra, reformim të pushtetit vendor i cili do të siguronte një qeverisje të qëndrueshme dhe kushte më të mira jetese për të gjithë qytetarët e Kosovës pa dallim.

Vasilija Staniq e Hasan Sopa, OSCE

Duke biseduar me disa nga përfaqësuesit e partive politike, kemi vërejtur se shumë prej tyre ndajnë një mendim të tillë dhe e shohin decentralizimin si një proces të pashmangshëm për të ardhmen e Kosovës. Ata gjithashtu mendojnë se ky është një proces afatgjatë dhe që kërkon përkushtim të sinqertë nga ana e autoriteteve vendore dhe angazhim të plotë të të gjitha palëve me interes në të gjitha nivelet. Kjo nuk do të thotë se nuk ka dallime në mendime dhe gjithsesi lexuesi do të vërej se në këtë artikull ekzistojnë dy qasje në lidhje me këtë.

## Decentralizimit duhet t'i qasemi me përkujdesje

Përfaqësuesit e partisë politike ORA e shohin decentralizimin si një proces të domosdoshëm dhe se duhet trajtuar së bashku me ndërtimin e sistemit të përgjithshëm juridiko-kushtetues në Kosovë. "Përveç kësaj konsiderojmë se decentralizimi kërkon konsensus të spektrit të gjerë politik kosovar i cili do ndërtohet mbi parimin e funksionalitetit dhe qëndrueshmërisë ekonomike dhe politike", shprehet Ylli Hoxha nga ORA.

Në parim askush nuk është kundër decentralizimit thotë Fehmi Mujota, anëtar i kryesisë së PDK-s dhe deputet në parlamentin e Kosovës. Sipas tij problemi është se shpesh decentralizimi shihet mbi baza nacionale dhe politike e jo mbi bazën e faktorëve të vërtetë; siç janë faktorët demografik, ekonomik, social e të tjerë. "Vënja e faktorit etnik në radhë të parë, e vë në dyshim të plotë procesin e decentralizimit në Kosovë dhe shton rrezikun e legjitimitetit të enklavave apo edhe ndarjen territoriale mbi baza etnike që do ta dëmtonte seriozisht këtë proces", shprehet Mujota.

## Nuk ka reforma parciale

Kosova gjithsesi meriton një administratë më efikase prandaj decentralizimi duhet të sigurojë një gjë të tillë. Sipas përfaqësuesve të PDK-së dhe ORA-s, reformimi i pushtetit vendor nuk mund të bëhet në mënyrë parciale dhe duhet të insistoj në eliminimin e strukturave paralele. "Kosovës i nevojitet përmirësimi i marrëdhënieve ndëretnike, veqanërisht në mes të shqiptarëve dhe serbëve. Mirëpo, në asnjë mënyrë nuk duhet të shërbej për të krijuar 'realitete territoriale etnike' të cilat do të mund ta rëndonin procesin e përcaktimit të statusit përfundimtar të Kosovës", nënvizon Hoxha.

Në anën tjetër, Mujota mendon se përderisa Kosova nuk ka status të definuar politik, është një sfidë e madhe të hyhet në një proces kaq të rëndësishëm. "Prandaj Kosovës së

pari i duhet zgjidhja e statusit final e pastaj t'i hyhet procesit të decentralizimit".

Sipas partisë politike ORA plani i paraqitur nga Qeveria ka mungesa esenciale të cilat do përmirësojë. Ata më tepër e shohin atë si një improvizim të bazuar në kompromiset momentale politike se sa një plan vërtetë frytdhënës. "Si të tillë konsiderojmë se qeveria duhet stopuar këtë proces, i cili në të ardhmen mund të paraqitet më tepër si pengesë se sa lehtësim për qeverisjen lokale".

"Patjetër duhet të bëhet një debat publik për decentralizimin, dhe duhet pasur një konsensus të plotë politik për mënyrën e reformimit të pushtetit vendor," Mujota. "Injorimi i institucioneve lokale në vendim-marrje e bën këtë proces edhe më të dyshimtë dhe shkakton huti në mesin e qytetarëve. Do të ishte një hap i gabuar dhe i pa krye nëse në parlament diskutohet pas vendimeve të kryera."

## Decentralizimi zgjidh problemet

Udhëheqësi i Listës Serbe të Kosovës dhe Metohisë (LSKM) Oliver Ivanoviq mendon se ekziston një lidhje direkte në mes të reformimit të pushtetit vendor dhe problemeve me të cilat ballafaqohet komuniteti serb siç janë: siguria, lëvizja e lirë, kthimi i të zhvendosurve, papunësia, zhvillimi ekonomik etj.

Ai beson se krijimi i komunave të reja do të ishte në interes të të dyja palëve, shqiptarëve dhe serbëve por edhe të tjerëve. "Pushteti vendor në formën ekzistuese nuk është në shërbim të qytetarëve dhe nuk ka qasje të njëjtë për të gjithë. Shembulli më i mirë për këtë është Prishtina." Sipas Ivanoviqit, popullsia e Prishtinës është shtuar dukshëm dhe arrin shifrën prej 500 mijë banorëve. Kjo e pamundëson një qasje të barabartë për të gjithë në këtë administratë. "Serbët nuk kanë qasje për shkak të kufizimit të lirisë së lëvizjes. Por gjithashtu, kjo nuk është në shërbim edhe të pjesës dërmuese të popullatës shqiptare që banojnë në zona ndërrurbane apo fshatra të izoluar. Me këtë numër të banorëve, zgjidhja më e mirë për Prishtinën do të ishte ndarja e saj dhe formimi i nëntë komunave të reja".

Në vazhdim ai shton: "Është mëse e nevojshme krijimi i komunave të reja me qëllim të sigurimit të një ndikimi më të madh të qytetarëve në proceset vendim-marrëse të qeverive vendore. Prandaj është shumë normale që shqiptarët nga Juniku duan të kenë komunën e tyre. Juniku është një fshat prej 5000 banorëve i cili është pjesë e komunës së Deçanit me popullsi mjaft të dendur. Por është gjithashtu normale që serbët të



Pozita e Partive Politike shpeshherë shkon në dy drejtime të ndryshme.

kërkojnë që Graçanica të bëhet komunë, dhe kjo nuk do të thotë se Graçanica duhet të jetë monoetnike".

## Strukturat paralele të tepërta

Pritet që të ashtuquajturat strukturat paralele në lëmin e shëndetësisë dhe arsimit, në zonat e banuara me popullsi shumicë serbe, të shkrihen në institucione të Kosovës.

"Strukturat paralele ekzistojnë ngase ekzistojnë arsytet për një gjë të tillë; siç janë frika dhe kushtet jo të sigurta për jetesë, mirëpo edhe për shkak se pjesa dërmuese e institucioneve nuk u ofrojnë atyre qasje të duhur. LSKM-ja insiston që plani i decentralizimit të mundësojë që shkollimi fillor dhe ai i mesëm si dhe përkujdesja shëndetësore të jenë përgjegjësi e komunave. Kjo do të ishte si parakusht për integrimin e strukturave paralele ekzistuese dhe të bëhen pjesë e sistemit kosovar. Kjo do të thotë se strukturat paralele si të tilla do të zhduken, pasi që edhe arsyeja për ekzistimin e tyre do të zhduket si e tillë", thotë Oliver Ivanoviqi.

## Pjesëmarrja në proces

Përfaqësuesit e LSKM-së nuk marrin pjesë në grupin punues i cili është duke përpiluar planin për vetëqeverisje lokale. Ivanoviqi beson se është gabim dhe rezultat i keqkuptimit në mes të LSKM-së dhe Beogradit. Mirëpo, duke i shfrytëzuar kontaktet e rregullta me përfaqësuesit e UNMiK-ut në grupin punues ata kanë mundësi të japin mendimet dhe sugjerimet e tyre. Disa nga këto sugjerime janë futur në draftin e planit, që do të thotë se edhe pse indirekt, megjithatë ata marrin pjesë në procesin e përpilimit të planit.

# Diskriminimi NDALOHET me ligj

## Ligji kundër diskriminimit është miratuar – fillon implementimi

Vetëm përpjekjet e IPVQ-ve, UNMIK-ut, shoqërisë civile dhe sektorit privat mund të garantojnë implementimin efikas dhe gjithëpërfshirës të Ligjit kundër Diskriminimit në Kosovë

Radoslaw Rzehak, OSBE

Në vjeshtën e vitit 2004, Kuvendi i Kosovës e miratoi kurse PSSP-ja nënshkroi Ligjin Kundër Diskriminimit (LkD). Kjo pjesë e rëndësishme e legjislacionit do ta avansoj edhe më tepër mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe do t'i ndihmoj zhvillimit të një shoqërie moderne.

Ky Ligj, i përpiluar me ndihmën e Misionit të OSBE-së në Kosovë, ndalon diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, si dhe definon të gjitha format e tij – ngacmimin, reprezalien si dhe segregacionin. Ai e adreson diskriminimin në të gjitha fushat kryesore të jetës: në punësim, shkollim, kujdes social, banim, siguri personale dhe qasje në jetën publike. Ajo që është më e rëndësishme, ky ligj i referohet edhe sektorit publik edhe atij privat. Si i tillë, ligji kundër diskriminimit është i pari në rajon, dhe e vë Kosovën përpara fqinjëve të saj.

**Diskriminim i drejtpërdrejt konsiderohet kur një person është apo ka qenë i trajtuar në mënyrë të disfavorshme nga një person tjetër në situatë të njëjtë vetëm sepse ai ose ajo i takon një gjinie, moshe, religjioni, flet gjuhë tjetër, ka të meta ose mendim tjetër politik etj.**

Risia kryesore e prezentuar nga Ligji kundër Diskriminimit është se barrën e dëshmisë e merr pala e akuzuar për kryerje të ndonjë akti diskriminues. Pra, një person ose institucion i akuzuar për sjellje diskriminuese duhet të dëshmoj se nuk ka ndodhur diskriminimi. Kështu, kjo nuk është më vetëm përgjegjësi e paditësit. Ka rëndësi të vaçantë sidomos në rastet kur një person paditë një institucion që mbanë pozitë më të lartë se ai.

Në përputhje me Ligjin, çdo person në Kosovë i cili ndihet i diskriminuar për çfardo arsye mund të bëjë ankesë. Në rast ankese, viktima gjithashtu mund të gëzoj edhe mbështetjen e organizatave dhe subjekteve ligjore. Është me rëndësi se Ligji i fuqizon gjykatat jo vetëm që t'i kompenzoj viktimat në rast trajtimi diskriminues, por edhe të ndëshkojnë institucionet të cilat shkelin urd-

hërat për parandalimin e diskriminimit. Për më tepër, Ligji e autorizon Ombudspersonin e Kosovës që të pranoj dhe hetoj ankesat lidhur me rastet diskriminuese.

**Ngacmimi përshkruhet si një veprim i padëshirueshëm (që përfshin por nuk kufizohet në sjellje të natyrës së padëshirueshme seksuale dhe/apo psikologjike), që ka për qëllim ose efektin e shkeljes së dinjitetit të një personi dhe/ose krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, degradues ose ofendues.**

Me qëllim që edhe ky ligj të ketë efektin e vet si të gjitha ligjet tjera, kërkon që të implementohet dhe promovohet plotësisht nga autoritetet. Në këtë nivel, implementimi i ligjit varet nga bashkëpunimi i plotë në mes të IPVQ-ve, UNMIK-ut, shoqërisë civile, si dhe sektorit privat. Të gjithë këta akterë duhet të kontribuojnë në eliminimin efikas të diskriminimit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ligji kundër diskriminimit inkurajon përdorimin e veprimeve pozitive që japin kompenzime për vështirësitë me të cilat janë ballafaquar grupet e dëmtuara, siç janë personat me të meta, gratë dhe minoritetet. Veprimet pozitive shtrihen prej prezantimit të kuotes minimale të punësimit të femrave dhe arrijnë deri te shtresat e pashkolluara dhe preferencat për rekrutimin e personave me të meta që kanë kualifikime të njëjta.

**Reprezalie konsiderohet kur një person përjeton trajtim të hidhur apo pasoja të hidhura si reagim ndaj diskriminimit.**

Me qëllim që t'i ndihmohet implementimit të procesit, Misioni i OSBE-së ka siguruar një mbështetje financiare dhe teknike për Zyrën Këshilldhënëse për Qeverisje të Mirë (ZKQM) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Hapi i parë është se ZKQM-ja është në konsultime me të gjithë faktorët relevant – përfaqësuesit e institucioneve qëndrore dhe vendore, KB-në, OSBE-në, Institucio-

nin e Ombudspersonit, Odën Ekonomike të Kosovës, Odën e Avokatëve të Kosovës, si dhe OJQ-të që përfaqësojnë grupe të ndryshme shoqërore – që përbëjnë grupin punues për implementimin e Ligjit kundër Diskriminimit.

Grupi do të zhvilloj një plan gjithëpërfshirës për implementimin e Ligjit dhe do të koordinoj përpjekjet e të gjithë akterëve që janë të përfshirë në këtë proces. Ai gjithashtu do t'i qartësoj procedurat e ankesave në rastet e diskriminimit.

Përveç kësaj, IPVQ-të tani janë përgjegjëse për zhvillimin e një fushate për ngritjen

**Segregacioni paraqitet kur një person veçohet në mënyrë të paarsyeshme nga të tjerët nga ana e një personi apo institucioni tjetër.**

e vetëdijës së opinionit për LkD-në. Sipas ligjit, Qeveria duhet ta informoj opinionin për specifikat e Ligjit, që është *conditio sine qua* (kusht i domosdoshëm) që Ligji të përdoret në mënyrë efektive nga çdo kosovar. Me qëllim të përmbushjes së këtij obligimi, ZKQM-ja planifikon të shtypë kopje të LkD-së në gjuhën shqipe, serbe dhe atë turke dhe t'i shpërndaj ato në tërë Kosovën. Për më tepër, ZKQM-ja do të shpërndajë, në shumicën e gjuhëve që fliten në Kosovë, edhe postera dhe fletushka që shpjegojnë normat themelore të Ligjit.

Së bashku me fushatën për ngritjen e vetëdijës së opinionit në përgjithësi është siguruar edhe një trajnim për gjykatës dhe prokurorë. Ky trajnim, i cili u organizua nga Instituti Gjyqësor i Kosovës, ishte i fokusuar në përdorimin praktik të Ligjit.

Interesimi i lartë që është shprehur deri më tani për LkD-në dhe implementimin e tij është një shenjë inkurajuese se ky Ligj do të jetë i plotëfuqishëm pa ndonjë vonesë të madhe.

Teksti i plotë i LkD-së në të gjitha gjuhët zyrtare mund të lexohet në web-faqen e Kuvendit të Kosovës [www.assemblyofkosovo.org](http://www.assemblyofkosovo.org) dhe së shpejti do të sigurohen edhe kopje të shtypura në çdo komunë.

DISKRIMINIMI NDALOHET ME  
LIGJ NGA SHTATORI

ДИСКРИМИНАЦИЈА ЈЕ  
ЗАКОНОМ ЗАБРАЊЕНА ОД  
СЕПТЕМБРА

EYLÜL 2004'ten İTİBAREN

DISKRIMINACIJA JE SOZ ZAKON  
ZABRANJENA OD SEPTEMBAR

DISKRIMINACIJA TANO O  
ZAKONI KOVACINAVDO ANO  
SEPTEBRO

2004

Diskriminimi direkt  
 Diskriminimi indirekt  
 Segregacioni  
 Frikësimi  
 Директна дискриминација  
 Индаиректна дискриминација  
 Сегрегација  
 Заstraшивање, Напастововање  
 Direkt ayrimcilik  
 Dolayli ayrimcilik  
 Farki gözetmek  
 Taciz etmek, Korkutmak  
 Direktna diskriminacija  
 Indirektna diskriminacija  
 Segregacija  
 Napastvovanje, Zaplašivanje  
 Uziangluni diskriminacija  
 Angluni diskriminacija  
 Segregaci  
 Lošnipe, Daraceriba